



NATIONAL
YOUTH
CONGRESS

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

BASHKIA
URË VAJGURE

MASTER PLANI I PUNËSIMIT

FALENDERIME

Master Plani i Punësimit në Bashkinë Urë Vajgurore është një dokument strategjik politikash dhe është krijuar në kuadër të projektit “Jeto Qytetin Tënd-Politikat Rinore në Nivel Lokal” me qëllim përmirësimin e politikave të punësimit dhe gjendjes aktuale të punësimit të rinjve në Bashkinë Urë Vajgurore. E njëjta iniciativë është ndërmarrë edhe në 11 bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Falenderime të veçanta i shkojnë Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung në Tiranë i cili ka mbështetur Kongresin Rinor Kombëtar dhe programin e dedikuar politikave rinore në nivel lokal prej tre vitesh.

Falenderime i shkojnë gjithashtu përfaqësuesve të administratës publike që morrën pjesë gjatë takimeve me fokus grupet përgjatë gjithë hartimit të Master Planit. Pa bashkëpunimin e tyre dhe ndarjen e informacioneve ky master plan nuk do të ishte i njëjti.

Falenderime shkojnë për bashkëautoren, Zoica Bardhi, koordinatorë lokale e qytetit të Urës Vajgurore, përfaqësuese e organizatës “New Bridges Berat”. Shpreh mirënjohje gjithashtu ndaj ekspertëve të cilët asistuan 12 koordinatorët lokalë në analizimin e situatës aktuale dhe evidentimin e problematikave dhe sygjërimeve të mundshme për përmirësimin e situatës. Faleminderime kolegëve koordinatorë të cilët ndanë eksperiencat dhe kontributin e tyre gjatë gjithë këtij procesi.

Mbi të gjitha falenderime të përzemërta i shkojnë të gjithë organizatave rinore lokale pjesë apo jo e Kongresit Rinor Kombëtar, pjesëmarrësve, të rinjve, aktivistëve, studenteve dhe qytetarëve të cilët morën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre gjatë fazës së konceptimit dhe dizenjimit të këtij dokumenti.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë dokument janë të Kongresit Rinor Kombëtar dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung.

TABELA E PËRMBAJTJES:

FALENDERIME

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	TË RINJTË DHE TREGU I PUNËS PËRMET	4
III.	OBJEKTIVAT	8
IV.	PARIMET UDHËHEQËSE	9
V.	SITUATA LIDHUR ME PUNËSIMIN NË BASHKINË URA VAJGURORE	11
VI.	ANEKSET	14
	ANEKSI I : ORIENTIMI DREJTË TREGUT TË PUNËS	14
	ANEKSI II : EDUKIMI DHE TRAJNIMI	18
	ANEKSI III : MUNDËSITË E PUNËSIMIT	21
	ANEKSI IV : AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM	23
	ANEKSI V : SIPËRMARRJA	23
	ANEKSI VI : PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL	25

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një nga vendet me popullësinë më të re në rajon ku të rinjtë nën moshën 30 vjeç përfaqësojnë 45.6% të popullësisë.

Kjo grup moshë kërkon një trajtim të veçantë dhe duhet të merret në konsideratë të vazhdueshme në hartimin e dokumentave strategjike pasi ata përbëjnë forcën më të lartë punëtore në qark dhe në bashki dhe janë komponentë kryesorë për zhvillimin e qytetit dhe vendit.

Ky masterplan vjen si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të Kongresit Rinor Kombëtar për të influencuar politikat rinore në nivel vendor dhe qendror me qëllim fuqizimin e të rinjve në 12 qarqet e vendit. Konkretisht në vitin 2017 Kongresi Rinor Kombëtar së bashku me institucionet publike dhe organizatat e saj partnere hartuan Planet Lokale Vendore, dokumente me rëndësi të veçantë për zhvillimin strategjik të të rinjve në 12 qarqet e Shqipërisë.

Në kuadër të projektit “Planet Lokale të Veprimit për Rininë - Jeto Qytetin Tënd” kemi zhvilluar takime dhe diskutime me grupime të të rinjve dhe organizatave rinore në 12 qarqet për të identifikuar problematikat dhe zgjidhjet e mundshme që prekin grupmoshën 15-29 vjeç.


Punësimi mbetet një problem madhor në rang kombëtar i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga organizatat rinore në bashkëpunim me autoritete lokale dhe komunitetin e biznesit. Për këtë qëllim ne kemi hartuar Masterplanin për Punësimin e të Rinjve në bashkitë përkatëse.

Ky masterplan i dedikohet vetëm Bashkisë Ura Vajgurore dhe ka si qëllim paraqitjen e situatës aktuale të punësimit të të rinjve në këtë bashki si dhe hartimin e objektivave strategjike shoqëruar me rekomandimet përkatëse. Ky dokument është i ndarë në pesë pjesë kryesore dhe është në vijueshmëri me dokumentat në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

II. TË RINJTË DHE TREGU I PUNËS NË URËN VAJGURORE

Në nivel kombëtar çështja e punësimit është një nga pesë prioritetet e kyçe të qeverisjes qendrore dhe lokale, sikurse pasqyrohet edhe në dokumentet strategjike të hartuara në nivel qendror dhe vendor. **Në nivel kombëtar**, dokumentet e rëndësishme të politikave janë:

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020. Objektivi Strategjik 2 i Planit është “Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës”. Një objektivë për arritjen e këtij qëllimi është “Rritja e kualifikimit profesional dhe menaxherial të të rinjve” nëpërmjet: Programeve trajnuese dhe shkollave verore për të rinjtë mbi këshillimin në karrierë, aftësimin profesional, menaxherial, hartimit të planeve të biznesit dhe sigurimit të fondeve; Konsulencës mbi aspektet ligjore, financiare dhe menaxheriale për bizneset fillestare të iniciuara nga të rinjtë; Forcimit të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore, institucionet shtetërore dhe private për ofrimin e praktikave profesionale dhe të akredituara; Organizimin e konkurseve rajonale “Ide krijuese” të shoqëruara me mekanizma nxitës dhe mbështetës; Zgjerimit të gamës së kurseve të ofruara nga Agjencitë e Formimit Profesional, të cilat duhet të ofrojnë kurse mbi profesione të reja sipas kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të zonave të ndryshme; Fushatave të ndërgjegjësimit për nxitjen e të rinjve të ndjekin kurse profesionale të lidhura me traditën dhe nevojat e zonave etj. Një tjetër objektivë për arritjen e qëllimit është “Promovimi dhe fuqizimi i programeve të nxitjes së punësimit rinor” nëpërmjet: Krijimit të inkubatorëve të biznesit; Nxitjen e punësimit ndërmjet programeve të punësimit; Mbështetjen e aktiviteteve (artizanale, bimë medicinale, pemtari, kopshtari) që nxisin vetë-punësimin e vajzave/grave të reja nga zonat rurale; Ofrimin e mjediseve për zhvillimin e bizneseve rinore, me çmime simbolike/të subvencionuara apo duke përdorur asetet shtetërore që nuk janë në përdorim aktual.



Programi i Qeverisë 2017-2021. Ky program, në seksionin e rinisë, parashikon hartimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, programe dhe projekte për nxitjen e punësimit, krijimin e një kuadri ligjor të qartë për rininë ku përcaktohen qartë kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me përgjegjësitë që kanë ndaj të rinjve, si dhe forcimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.


Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZHI) përcakton një qasje të integruar për zhvillimin socio-ekonomik të vendit po ashtu dhe për integrimin në BE. Impakti që kjo strategji kërkon është në 3 këndvështrime: së pari, një zhvillim ekonomik më i madh përmes rritjes së tregut të punës, forcimit të arsimit – duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, vullnetarizmin dhe minimizimin e ekonomisë informale. Së dyti, ka qëllim shndërrimin e rritjes ekonomike në mirëqenie sociale, përmes investimit në shërbime publike që ndihmojnë përfshirjen, kohezionin dhe cilësinë e jetës. Aksi i tretë i strategjisë bazohet në fuqizimin e qeverisjes, demokracinë dhe parametrat e ligjit të së drejtës.

Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020 ka qëllim ndërtimin e një fuqie punëtore më të arsimuar dhe të aftë sipas nevojave të tregut të punës. Politikat prioritare të identifikuar janë: a) forcimi i mundësive të punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës, ku ofrimi i sa më shumë mundësive për të rinjtë është një prioritet; b) ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor dhe trajnimit të të rinjve dhe të rriturve; c) nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial; dhe d) forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

Në **nivel lokal** paraqitet në dokumentat si:

Plani i Veprimit për Rininë 2020-2023.

Plani i Përgjithshëm Vendor/Plani i Zhvillimit Strategjik (2017). Ky dokument përfshin vizionin vendor të zhvillimit territorial, mjedisor e social-ekonomik dhe objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit. Vizioni strategjik që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Urës Vajgurore gjatë 15 viteve të ardhshme është, një qytet "që mbart vlera të trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukture moderne, si një destination i fuqishëm turistik dhe portë hyrëse pritëse për një rajon të pasur natyror". Ura Vajgurore synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me punësimin, mbrojtjen e natyrës, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual.




Programi Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 Bashkia Ura Vajgurore. Programi përfshin projektet kryesore, arsyet dhe përfituesit bazuar në fishat e projekteve të PPV/PZhS. Punësimi përfshihet në seksionin “Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës”. Lidhur me çështjet e përgjithshme ekonomike dhe tregtare Programi thekson: Formulimin, zbatimin e monitorimin e politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Mbajtjen e kontakteve mes qeverisjes dhe biznesit për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik. Lidhur me mbështetjen për zhvillim ekonomik, Programi thekson: Mbështetje marketing për bizneset vendore; Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare dhe për të nxitur punësimin.

Plani i Kujdesit Social, Bashkia Ura Vajgurore, 2019 – 2023. Plani adreson nevojat për shërbime të kujdesit social, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes së shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë. Plani i përgjigjet kërkesave të reformës administrative-territoriale që ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel lokal. Plani është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për grupet më prioritare bazuar në partneritetet ndërmjet aktorëve të ndryshëm (institucionet e qeverisjes rajonale, organizatat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, biznesin vendor).

Në **nivel ndërkombëtar:**

Iniciativa për Punësimin Rinor (Youth Employment Initiative-YEI; BE). YEI është lancuar në 2013 dhe synon të reduktojë nivelet e papunësisë tek të rinjtë në rajonet më të prekura të Bashkimit Evropian (ato që në vitin 2012 kishin nivelin e papunësisë tek të rinjtë mbi 25%) duke financuar iniciativat që ndihmojnë në aksesin e të rinjve në tregun e punës në këto rajone. Kjo iniciativë mbështet të rinjtë nga 15-24 (ose 15-29 në disa vende të BE) të cilët nuk janë në shkollë, punë, apo në trajnim, përfshirë të papunët afat-gjatë dhe punë-kërkuesit e paregjistruar. Financimi përdoret për zbatimin e Paketës së Punësimit Rinor, veçanërisht skemat nacionale të Garancisë Rinore. Iniciativa shkon direkt tek të rinjtë dhe i mbështet ata në nivel personal. Oferta shkon nga praktikat dhe kurset e trajnimit deri tek mbështetja për punëdhënësit dhe start-up të të rinjve, në varësi të nevojave specifike të të rinjve. Në këtë mënyrë, Iniciativa plotëson mbështetjen nga instrumentet e tjerë të mbështetjes financiare sic është Fondi Social Evropian (European Social Fund-ESF), i cili fokusohet në reformat e arsimit dhe punësimit. Pavarësisht se kjo Iniciativë targeton vendet anëtare të Bashkimit Evropian, ajo është një shembull shumë i mirë i mbështetjes për punësimin rinor të të rinjve nga grupet e marginalizuara.





Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020 është në thelb të Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen Sociale 2007-2016, e cila përcakton mekanizmat dhe strategjitë për përfshirje sociale gjatë ciklit të jetës së individëve si: fëmijët, individët në moshë pune, të moshuarit, personat me aftësitë kufizuar dhe komunitetet. Për më tepër, është mbështetur nga programi i Progresit, një instrument financiar që ka për qëllim zhvillimin e politikave në 5 fusha strategjike: punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, kushtet e punës, anti-diskriminimi dhe barazia gjinore.

Strategjia Europa 2020 ka qëllim nxjer rjen e 20 milion njerëzve nga varfëria, luftën ndaj përjashtimit social dhe forcimin e punësimit. Iniciativat kryesore nën këtë strategji janë Platforma kundër Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale dhe Axhenda për Aftësi të reja dhe Vende pune.

Për të arritur një mirë menaxhim të burimeve natyrore, financiare dhe kapitalit njerëzor në nivel kombëtar dhe lokal është e nevojshme të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe e mirëdetajuar e tregut të punës për të matur atë se çfarë kërkohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në vendin e punës për të dalë me përfundime dhe rekomandime konkrete. Ajo çka duhet të theksohet është fakti se kjo analizë mungon çka e bënë jo të qartë për aktorët që punojnë se ku duhet ti prioritetizojnë fondet dhe veprimet e tyre. Mbivendosja e punës, ripërseritja dhe kosto janë problematika që vijnë pikërisht nga kjo mungesë.

Përsa i përket punësimit Bashkia Ura Vajguore ka hartuar një sërë politikash ekonomike për tu ardhur në ndihmë të rinjve dhe grupeve të marginalizuara. Aktualisht janë zhvilluar një sërë politikash dhe programesh si: Plani i Veprimit për Rininë 2020-2023. Lidhur ngushtë me punëmin lidhet dhe çështja e aftësimin e cila synon krijimin e nj force punëtore të kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e tregut. Për këtë arsye është e nevojshme hartimi i politikave dhe programeve plotësuese siç janë: trajnimet, praktikat dhe edukimi jo-formal.

Përsa i përket mbështetjes financiare dhe nxitjes së punësimit Bashkia Ura Vajguore do të fokusohet në dy programe kryesore siç janë: Punësimi dhe vetëpunësimi i të rinjve dhe rritja e kapaciteteve të të rinjve për tu integruar më mirë në vendin e punës.

III. OBJEKTIVAT

Objektivat e këtij MasterPlani janë si më poshtë:

- ▶ Të krijojë një kuadër cilësor dhe dinjiteti për punësimin e të rinjve.
- ▶ Të formojë të rinjtë si agjent ndryshimi të situatës së tyre drejtë integritit në tregun e punës.
- ▶ Të ofrojë asistencë të personalizuar në zhvillimin personal të të rinjve dhe mundësive të karrierës në Ura Vajguore dhe NJA rurale.
- ▶ Të përmirësojë integrimin dhe qëndrueshmërinë e të rinjve në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit personal dhe profesional dhe kualifikimeve të vazhdueshme.
- ▶ Rritja e aksesueshmërisë së tregut të punës dhe programeve të aftësimin për grupet e marginalizuara dhe gratë dhe vajzat.
- ▶ Të sigurojë përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në tregun e punës dhe mundësitë e barabarta të punësimit dhe zhvillimit profesional.
- ▶ Të rrisë bashkëpunimin midis aktorëve publik dhe privat që operojnë në fushën e punësimit, zhvillimit të karrierës dhe kualifikimeve profesionale.
- ▶ Të nxisë sipërmarrjen rinore.



IV. PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet udhëheqëse janë në përputhshmëri me strategjitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të punës tek të rinjtë. Ato janë baza mbi të cilat do të hartohen dhe dizajnohen të gjitha veprimet që do të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes aktuale të punësimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.


Përshtatja me direktivat Europiane: Më hyrjen në Bashkimin European tregu i punës në Shqipëri do të përballë me një sërë ndryshimesh ndaj është e nevojshme të kuptojmë këto ndryshime duke filluar nga: standarti i tregut të punës, konkurrueshmëria në aftësitë profesionale, kuadri ligjor dhe institucional, dixhitalizimi, lëvizja e lirë e mallrave dhe standarti i produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye është e rëndësishme të ndërmarrim hapa që në një plan afatgjatë do ti shërbejnë pikërisht këtyre ndryshimeve si dhe minimizimit të rreziqeve dhe kostove të bizneseve shqiptare dhe punonjësve shqiptarë.

Zhvillimi i Qëndrueshëm: Ky parim udhëheq çdo dokument strategjik që hartohet në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Menaxhimi i burimeve dhe planifikimi i integruar social dhe ekonomik janë shtyllat kryesore ku mbështetet ky parim.

Bashkërendimi: Ky master plan është hartuar duke u bashkërenduar me dokumentat strategjike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar më qëllim harmonizimin e punës dhe zhvillimin e aktiviteteve në të mirë të interesave qytetare dhe grupeve të synuara kryesisht të rinjtë.

Punësim Cilësor: për të gjithë: Ky parim synon zhvillimin e individëve duke ofruar asistencë të personalizuar në të gjitha fazat përgatitore drejt tregut të punës si dhe aftësimin dhe trajnimeve të vazhdueshme.

Gjithëpërfshirja dhe Mos-diskriminimi: Ky parim siguron përfshirjen sociale duke u fokusuar më së shumti tek grupet e marginalizuara siç janë gratë dhe vajzat, vajzat që janë viktime të dhunës, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë në zona rurale dhe emigrantët. Gjithashtu ky parim siguron mundësi të barabarta punësimi dhe kualifikimi të individëve që vijnë nga këto grupe.



Mbështetja e prodhimit vendas dhe ekonomisë lokale: Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian është e rëndësishme zhvillimi i tregut lokal dhe rajonal të punës, produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye nxitja e prodhimtarisë dhe ekonomisë lokale do të shoqërohet me krijime të reja të vendeve të punës dhe uljes së papunësisë. Ky parim mbështet të gjitha nismat dhe programet që do të ndërmerren në kuadër të këtij master plani.

Zhvillimi personal dhe profesional: Ky parim synon të vendosë të rinjtë në qendër të gjithë nismave në mënyrë që të rrisë kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e të rinjve për tu përshtatur në vendin e punës. Ky parim do të mbështetet në ciklin e zhvillimit personal dhe profesional duke i bërë të rinjtë agjentë ndryshimi të jetës së tyre.

Bashkëpunim dhe dialog konstruktiv: Për të arritur sa më mirë përmbushjen e objektivave të këtij dokumenti është e rëndësishme bashkëpunimi me të gjithë aktorët e përfshirë si: institucionet lokale, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e arsimit të mesëm, institucionet e arsimit profesional, komuniteti i biznesit, akademikë dhe studiues, organizatat rinore, organizatat e biznesit, sindikatat e punëtorëve dhe të rinjtë.



V. SITUATA LIDHUR ME PUNËSIMIN NË BASHKINË URA VAJGURORE


Në nivel kombëtar, punësimi mbetet problem për shoqërinë shqiptare. Mesatarja e përqindjes së të punësuarve për të rinjtë e grup-moshës 15-29 vjeç, gjatë periudhës 2007-2018, është 34.4%, pak a shumë sa gjysma e përqindjes së të punësuarve për individët e grup-moshës 30-64 vjeç (të cilët punësimin e kanë në mesataren 65.3%). Aktualisht, përqindja e të papunëve tek grup-mosha 15-29 vjeç është 23.4%.

Arsyet janë se grup-mosha 15-29 vjeç përfshin të rinjtë që:

- [1]** nuk e kanë nisur ende ose sapo e kanë nisur karrierën e tyre profesionale;
- [2]** gjenden në periudhën e testimit në tregun e punës të aftësive të tyre prodhuese e krijuese për profesionin dhe/apo karrierën që do duhet të zgjedhin;
- [3]** janë tepër aktivë dhe persistentë në kërkimin e një vendi pune të qëndrueshëm që u përshtatet.

Luhatjet tek punësimi i të rinjve janë shumë më të shpeshta, duke reflektuar pasiguri të mbajtjes së vendit të punës, krahasuar me grup-moshën 30-64 vjeç. Të rinjtë, edhe pse janë pjesa më produktive dhe aktive e popullsisë, vuajnë pasojat e papunësisë dhe mbi të gjitha mungesën e politikave që mbështesin fuqizimin dhe hapjen e bizneseve rinore dhe rrjedhimisht rrisin numrin e të rinjve të punësuar.

Në Shqipëri, në popullsinë në moshë pune të rinjtë përbëjnë vetëm 37%. Në popullsinë ekonomikisht joaktive rreth 65% janë femra dhe 56% janë të rinj të moshës 15-29 vjeç. 55% e individëve të grup-moshës 15-29 vjeç janë femra. Popullsia ekonomikisht joaktive në Shqipëri përfshin një masë të konsiderueshme individësh të prirur për punësim, të cilët, pavarësisht se nuk kategorizohen dhe nuk raportohen si të papunë, janë tepër të predispozuar për të filluar punë sapo mundësitë të jepen.




Bashkia Ura Vajgurore ka një sipërfaqe prej 156.56 km², 27,295 banorë sipas INSTAT (39,991 sipas Regjistrit të Gjendjes Civile), që jetojnë në 1 qytet dhe 33 fshatra. Migracioni i lartë dhe i vazhdueshëm dhe rënia e lindshmërisë kanë ndikuar në ndryshimin e strukturës demografike edhe në rënien e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Bashkisë. Qyteti i Urës Vajgurore është rreth 105 km larg Tiranës, 72 km nga porti i Durrësit, 65 km nga porti i Vlorës dhe 230 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Ura Vajgurore janë bujqësia dhe blektoria. Bashkia shtrihet në një zonë të pasur bujqësore (toka bujqësore është rreth 10,046 ha e shtrirë në terren fushor-kodrinor dhe shumë pjellore). Edhe punësimi në këtë bashki është i orientuar kryesisht drejt bujqësisë. Përsa i përket agropërpunimit, në territorin e Bashkisë ushtrojnë aktivitetin 9 linja të përpunimit të qumështit (përfshirë edhe kompania Erzeni), 13 fabrika të përpunimit të vajit, një linjë të konservimit të frutave dhe perimeve, 2 fabrika mielli, 1 linjë e pijeve alkoolike, 12 firma të grumbullimit të perimeve dhe një thertore sipas standarteve. Gjithashtu Ura Vajgurore njihet për minierat sipërfaqësore të gurit dhe për përpunimin e gurit në granil dhe gëlqere ku janë përqëndruar shumë kompani private. Aktualisht në këtë bashki ushtrojnë aktivitetin e tyre 650 biznese dhe 7,124 ferma bujqësore.

Potenciali turistik i Urës Vajgurore që lidhet me vlerat e saj historike (Kalaja e Dimalit), kulturore, artistike dhe fetare dhe lidhjen me destinacionet turistike si qyteti muze i Beratit dhe Parku Kombëtar i Tomorit mund të jetë i rëndësishëm për punësimin dhe zhvillimin ekonomik.

Bashkia Ura Vajgurore përballet me çështjen e papunësisë tek të rinjtë. Për të siguruar që bashkia zhvillohet ekonomikisht, prioritet i saj është punësimi, sidomos për grupet e margjinalizuar siç janë të rinjtë. Papunësia tek të rinjtë ka pasoja afat-shkurtëra dhe afat-gjata negative: ulja e të ardhurave, humbja e aftësive, humbja e shpresës, probleme psikologjike dhe të shëndetit fizik, përfshirja në fenomene negative, etj.



Bashkia Ura Vajguore përballet me çështjen e papunësisë tek të rinjtë. Për të siguruar që bashkia zhvillohet ekonomikisht, prioritet i saj është punësimi, sidomos për grupet e margjinalizuara siç janë të rinjtë. Papunësia tek të rinjtë ka pasoja afat-shkurtëra dhe afat-gjata negative: ulja e të ardhurave, humbja e aftësive, humbja e shpresës, probleme psikologjike dhe të shëndetit fizik, përfshirja në fenomene negative, etj.

Shumë të rinj përpiqen të gjejnë punë, por nuk kanë njohuritë, aftësitë dhe lidhjet profesionale për të mësuar rreth dhe shfrytëzuar mundësitë e punësimit. Sfidat janë sidomos të mëdha për të rinjtë nga grupet vulnerable.

Për të arritur një mirë menaxhim të burimeve natyrore, financiare dhe kapitalit njerëzor në nivel lokal është e nevojshme të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe e mirëdetajuar e tregut të punës për të matur atë se çfarë kërkohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në vendin e punës për të dalë me përfundime dhe rekomandime konkrete. Ajo çka duhet të theksohet është fakti se kjo analizë mungon çka e bënë jo të qartë për aktorët që punojnë se ku duhet ti prioritizojnë fondet dhe veprimet e tyre. Mbivendosja e punës, ripërsëritja dhe kosto janë problematika që vijnë pikërisht nga kjo mungesë.

Përsa i përket punësimit Bashkia Ura Vajguore ka hartuar një sërë politikash ekonomike për tu ardhur në ndihmë të rinjve dhe grupeve të margjinalizuara. Aktualisht janë zhvilluar një sërë politikash dhe programesh si: Plani i Veprimit për Rininë 2020-2023. Lidhur ngushtë me punësimin lidhet dhe çështja e aftësimin e cila synon krijimin e një force punëtore të kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e tregut. Për këtë arsye është e nevojshme hartimi i politikave dhe programeve plotësuese siç janë: trajnimet, praktikat dhe edukimi jo-formal. Bashkia Ura Vajguore do të fokusohet në dy programe kryesore siç janë: (1) Punësimi dhe vetëpunësimi i të rinjve dhe (2) Rritja e kapaciteteve të të rinjve për tu integruar më mirë në vendin e punës. Gjithashtu Bashkia Ura Vajguore do të mbështesë sipërmarrjen rinore.

VI. ANEKSET

Për të arritur përmbushjen e objektivave të lartë përmendura është e rëndësishme të formulojmë masterplanin e punësimit i cili është i ndarë në gjashtë anekse.

Qëllimi: Prioritizimi i aksioneve që do të ndërmerren në vitet pasardhëse kryesisht për reduktimin e numrit të të rinjve të papunë, përmirësimin e cilësisë së forcës punëtore, fasilitimin drejt vendit të punës dhe zvogëlimin e hendekut gjinor në tregun e punës.

ANEKSI I: ORIENTIMI DREJT TREGUT TË PUNËS

Qëllimi kryesor: Informimi, orientimi profesional, motivimi, këshillimi, diagnostifikimi dhe përcaktimi i profilit të karrierës përfshirë këtu edhe kompetencat, kërkimi për një vend pune dhe ndërmjetësimi në tregun e punës.


OBJEKTIV: Këshillimi i karrierës dhe asistencë e personalizuar

Këshillimi i karrierës është një fazë shumë e rëndësishme e cila i paraprin fazave pasardhëse për kërkimin e vendit të punës. Kjo fazë është e lidhur ngushtë me zhvillimin personal të individëve dhe formimin e tyre të përgjithshëm dhe akademik. Kjo fazë është e një rëndësie të veçantë pasi nëse hartohet dhe zhvillohet në mënyrën e duhur sjell reduktimin e një sërë kostove duke filluar nga kostot financiare dhe sociale dhe duke sjellë kështu reduktim të dukshëm të numrit të papunësisë. Gjithashtu kjo fazë i shërben individëve të riorganizojnë dhe të mirë menaxhojnë burimet e tyre, njohuritë dhe aftësitë për një kërkim më efikas të mundësive aktuale të punësimit në Bashkinë Urë Vajguore por dhe për zhvillimin e mundësive të reja në këtë territor. Aksionet kryesore përfshijne:

Aksioni 1: Formimi i Grupit Këshillimor të Karrierës

Sfida e realizimit të një analize të mirëfilltë të tregut të punës sjell me vete vështirësi për të kuptuar realisht cilat janë nevojat e punëkërkuesve dhe punëmarrësve në tregun e punës në Shqipëri. Kjo është një sfidë në nivel kombëtar dhe lokal i cili ka nevojë për një ndërhyrje sa më të shpejtë.





Formimi i **Grupit Këshillimor të Karrierës** synon më tej formimin e një grupi prej 100 individësh në nivel lokal të kualifikuar specifikisht për orientimin dhe këshillimin e të rinjve. Ky hap përfshin këshillim të personalizuar të individëve sidomos të rinjve duke u bazuar tek interesat, aftësitë e tyre, nevojën e tregut të punës dhe politikat shtetërore. Ajo çka e lidh këtë grup me analizën e tregut të punës është pikërisht analizimi i nevojave specifike të punëkërkuësve dhe fasiltimi i tyre në procesin e zhvillimit personal dhe profesional.


Puna e Grupit Këshillimor të Karrierës do të komplementohet nga një grup **ndërmjetësuesish** rinorë të cilët do të vijnë nga organizatat rinore.

Grupi Këshillimor i Karrierës do të hartojë një **Program Individual Orientimi** i cili do të përfshijë: diagnostifikimin personal, planin personal të zhvillimit dhe planin personal të trajnimit dhe kualifikimit. Në mënyrë që të zhvillohet ky program është e rëndësishme që grupi i këshilluesve të trajnohet paraprakisht dhe të pajiset me informacionin dhe aftësitë e duhura për të përmbushur me sukses fazën e parë. Ky grup duhet të përfshijë ekspertë të fushës, punonjës të burimeve njerëzore, trajnerë dhe mentorë lidhur me zhvillimin personal dhe profesional, përfaqësues nga organizata rinore dhe nga institucionet e përfshira në hartimin e këtij programi si dhe përfaqësues nga institucionet arsimore dhe komuniteti i biznesit. Hartimi i këtij programi do të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe mos-diskriminimit.

Aksioni 2: Diagnostifikimi dhe Programi Individual i Orientimit Drejt Tregut të Punës

Kualifikimi i forcës punëtore dhe mospërputhja midis aftësive dhe edukimit formal mbetet një nga arsyet kryesore të numrit të lartë të papunësisë tek të rinjtë. Për këtë arsye është e rëndësishme krijimi i një programi që do të analizojë nevojat specifike, njohuritë dhe aftësitë në nivel individual. Hapi i parë i këtij programi do të jetë diagnostifikimi individual dhe ndërtimi i një profili personal që do të përfshijë: aftësitë, kompetencat, eksperiencat, trajnimet, interesat, gjendjen aktuale në familje dhe mundësitë e karrierës.





Ky informacion do të përdoret në momentin e krijimit të planit të zhvillimit personal dhe profesional si dhe klasifikimin në bazë të nevojave të tregut të punës. Plani i Zhvillimit Personal dhe Profesional do të dizajnohet së bashku me punëkërkesin dhe për këtë arsye është e nevojshme të nënshkruhet një dakortësim midis tij dhe Zyrës së Karrierës në Bashki me qëllim mbrojtjen e përdorimit të të dhënave si dhe sigurimin e vazhdimësisë në hapat pasardhës deri në momentin e punësimit. *Ky plan do përfshijë:*

1. Identifikimin e nevojave për krijimin e planit të zhvillimit personal bazuar në parimet europiane me synim formimin e qytetarëve të ardhshëm europian të përgjëgjshëm dhe të ndërgjëgjësuar më integrimin në tregun ndërkombëtar të punës
2. Identifikimin e mundësive të karrierës në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar
3. Identifikimin e nevojave për krijimin e planit të zhvillimit profesional duke përfshirë eksperiencat e mëparshme në tregun e punës si dhe trajnimet dhe kualifikimet sipas metodës jo-formale të edukimit.
4. Njohjen me të drejtat e individit në tregun e punës si dhe njohjen me legjislacionin në fuqi për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë.
5. Kërkimi i vendeve aktive të punës dhe asistenca deri në momentin e punësimit
6. Pajisja e individëve me njohuri bazike dhe të avancuara përsa i përket hapave të kërkimit të vendit të punës.
7. Ngritje kapacitetesh në aftësitë e buta (soft skills), aftësi dixhitale dhe aftësi që lidhen me vendin e punës si përsëmbull: krijimi i një curriculum vitae, komunikimi, mendimi analitik, puna në grup, menaxhimi i kohës dhe stresit në vendin e punës, siguria në punë dhe krijimi i profilit personal në platforma dixhitale që lidhen me rrjetëzimin profesional siç është LinkedIn.



Aksioni 3: Formimi i grupit të Ndërmjetësuesve Rinorë

Ndërmjetësuesit Rinorë do të jenë një grup i cili do të asistojë drejtpërdrejtë në punën e Grupit Këshillimor të Karrierës dhe do të përcjellin tek ta zërin e të rinjve. Anasjelltas ata gjithashtu do të komunikojnë punën e grupit Këshillimor të Karrierës tek qytetarët dhe rrjetet e tyre për të përhapur në këtë mënyrë informacionin. Ata do të asistojnë të gjitha aktivitetet dhe do të kenë si detyrë kryesore komunikimin dhe vizibilitetin e brendshëm dhe të jashtëm të këtyre aktiviteteve. Ky grup do të përbëhet nga përfaqësues nga organizatat dhe qendrat rinore, përfaqësues nga shërbimi kombëtar i rinisë, përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve, grupimeve informale rinore, si dhe përfaqësues nga grupet e marginalizuara.

Aksioni 4: Këshillim gjithëpërfshirës i të rinjve që vijnë nga zonat rurale, gratë, vajzat, komunitete të ndryshme në Shqipëri si dhe personat me aftësitë të kufizuar.

Programi Individual i Orientimit do të kushtojë rëndësi të veçantë të rinjve që vijnë nga zonat rurale dhe grupet e marginalizuara. Duke qenë se numri i papunësisë është më i lartë tek këta individë dhe aksesueshmëria e informacionit dhe lokacioneve për mundësi zhvillimi dhe trajnimi është më e vështirë atëherë lind nevoja që zhvillimi i aktiviteteve që do të përmbajë ky program të kryhet pranë zonave ku këta të rinj të kenë akses.

OBJEKTIVI : Raporti me Aktorët e Tregut të Punës

Një objektivi tjetër i Programit Individual të Orientimit do të jetë dhe krijimi i urave lidhëse midis aktorëve të ndryshëm që janë pjesë aktive e tregut të punës. Këtu përfshihen institucionet arsimore të arsimit të lartë, arsimit të mesëm dhe arsimit profesional, agjensitë shtetërore lidhur me punësimin, komuniteti i biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Aksionet kryesore përfshijnë:

Aksion 1. Takime dhe trajnime të përbashkëta të aktorëve të përfshirë kryesisht rreth zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të punës dhe një qasjeje më miqësore për të rinjtë në formën e praktikave, punës në distancë apo teorisë dhe praktikës së integruar.



Aksion 2. Trajnimi i komunitetit i biznesit me qasjen europiane dhe aftësinë për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian. Aftësia për tu përshtatur me ndryshimet që do të pësojë ky komunitet me hyrjen në BE mund të krijojë hapësira për punësimin dhe integrimin e të rinjve në strukturat e tyre.

ANEKSI II: EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Fusha e edukimit dhe trajnimit është një fushë shumë e gjerë dhe duke qenë se tregu është në lëvizje të vazhdueshme nevoja për trajnime dhe kualifikime është gjithmonë prezente. Gjithashtu, në krahasim me bashkitë e mëdha, Ura Vajguore nuk ofron mundësi dhe aktorë që punojnë intensivisht në këtë fushë. Ky aneks synon të përmbushë objektivat e mëposhtme:

OBJEKTIV: Përmirësimi i Forcës Punëtore të Kompanive dhe Bizneseve

Kapitali njerëzor është një nga asetet më të çmuara të një biznesi dhe është gjithashtu një kapital i cili ka në dorë jetëgjatësinë dhe prezencën e një biznesi në tregun e punës. Me këtë nënkuptojmë se në nivel lidershipi vendimet që drejtuesit marrin për bizneset apo punonjësit e tyre përcaktojnë edhe të ardhmen e një biznesi. Duke qenë se tregu i punës është i ndryshueshëm i ndikuar më së shumti nga faktori demografik, klimatik, politik dhe teknologjik nevoja për të përshtatur kapitalin njerëzor me këto ndryshime është thelbësore në qëndrueshmërinë e një biznesi. Me integrimin në BE, Shqipëria do të pësojë ndryshime në shumë fusha dhe komuniteti i biznesit është ai që ka një rrezikshmëri të lartë nëse liderët e bizneseve nuk ndërgjëgjësohen dhe informohen në lidhje me këto ndryshime. Konkurrenca, standartet e reja, formalitete dhe zhvillimi i aftësive janë disa nga sfidat kryesore.



Aksionet kryesore perfshijne:

Aksioni 1: Krijimi i Mundësive për Kualifikime Profesionale Dhe Zhvillimi i Aftësive që Lidhen me Tregun e Punës

Në këtë kuadër disa nga hapat e rëndësishëm janë:

- ▶ Vlerësimi i nivelit të aftësive të të rinjve dhe mundësive të tyre për punësim.
- ▶ Informimi i të rinjve mbi mundësitë për kualifikim profesional (broshurë informative me informacione mbi mundësitë për të ndjekur kurset profesionale, sesione informimi për të rinjtë të ndjekin kurse profesionale të lidhura me traditën dhe nevojat e zones, vizita të nxënësve dhe të rinjve të papunë në shkollat rajonale të AFP, etj.).
- ▶ Zhvillimi i trajnimeve për aftësimin e të rinjve në tregun e punës. Bashkëpunimi me Agjencitë e Formimit Profesional për ofrimin e kurseve mbi profesione që janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe traditës apo nevojave të zonës së Urës Vajgurore. Bashkëpunimi me Agjencitë e Formimit Profesional për ngritjen e qendrave të formimit profesional pranë qendrave të banuara.
- ▶ Bashkëpunimi me institucionet lokale dhe bizneset lokale për zhvillimin e praktikave profesionale.
- ▶ Ofrimi i trajnimeve dhe kurseve të formimit për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, mundësitë e biznesit, procedurat vendore, etj.
- ▶ Zhvillimi i aftësive të buta. Aftësitë e buta (soft skills), gjuhët e huaja, aftësitë dixhitale janë ato aftësi të cilat para 10 viteve konsideroheshin një aset më shumë në profilin profesional të individëve. Në tregun e sotshëm ato shihen si standarte bazë dhe kërkohen nga çdo punëdhënës. Për këtë arsye është e nevojshme zhvillimi i kurseve dhe kompeticioneve në nivel lokal lidhur më fusha si: debati dhe dialogu konstruktiv, muzika, arti, kodimi, dizenjimi, sporti etj.

Aksioni 2: Marrëveshje Bashkëpunimi Midis Shkollave dhe Bizneseve

Për të rritur shancin e punësimit është e rëndësishme një bashkëpunim i ngushtë midis shkollave dhe bizneseve. Përshtatja e metodologjisë mësimore dhe anën praktike do të shoqërohet me një impakt shumë pozitiv dhe tek të rinjtë pasi do kenë mundësi të testojnë njohuritë e tyre në praktikë por dhe të kuptojnë se si funksionon tregu i punës.

OBJEKTIV: Suport drejt Tranzicionit në Tregun e Punës nëpërmjet zhvillimit të Aftësi dhe Kompetencave

Për të rritur shancet për integrimin në tregun e punës është e nevojshme që fuqia punëtore të njohë shumë mirë si funksionon tregu, si ndryshon dhe se si ata mund të përshtaten më këto ndryshime. Në këtë objektiv fokusi kryesor do të jetë zhvillimi i kompetencave bazë jo vetëm për të përmbushur një CV të pasur por edhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e punës. Aksionet për të përmbushur këtë objektiv do të hartohen në formën e programeve të cilat do të lancohen nga Zyra e Karrierës në Bashkinë Ura Vajguore dhe do të përfshijnë:

Aksioni 1: Trajnime mbi kompetencat bazë

Aksioni 2: Trajnime mbi kompetencat dixhitale

Aksioni 3: Trajnime mbi gjuhët e huaja dhe mundësitë e mobilitetit për studime dhe punë

Aksioni 4: Trajnime në bujqësi, blegori dhe agroturizëm

Aksioni 5: Programe bursash për studentët në vështirësi ekonomike

Aksioni 6: Trajnime midis brezave të ndryshëm për shkëmbim informacioni dhe kompetencash

Aksioni 7: Trajnime për stafet e bizneseve apo institucioneve për asistimin e grupeve të marginalizuara në tregun e punës dhe gjithëpërfshirjen.

ANEKSI III: MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Ky aneks i dedikohet kryesisht grupeve të marginalizuara në mënyrë që të nxisë punëdhënësit të punësojnë, krijojnë hapësira dhe të mbajnë në punë individë të cilët kanë vështirësi në ndërrimin e punës dhe gjenden në situatë ku kanë nevojë për suport ekonomik. Këtu përfshihen kryesisht personat më aftësi të kufizuar, gratë viktime të dhunës, emigrantët, viktime të terrorizmit apo të rinjtë që kanë probleme në familje dhe strehohen në qendra sociale.

Të rinjtë kryesisht janë më të pasigurtë pasi mund të bien më lehtësisht pre e abuzimeve dhe të përjashtohen nga aksesueshmëria në vendin e punës. Ky aneks synon përmbushjen e objektivave si më poshtë:

OBJEKTIV: Rritja e Aksesueshmërisë në Tregun e Punës

Aksionet kryesore përfshijnë:

Aksioni 1. Forcimi i kapacitetit të bashkisë lidhur me punësimin.

Krijimi i Zyrës së Informimit për punësim në Bashki. Trajnimi i stafit të bashkisë në çështjet e punësimit dhe sipërmarrjes rinore.

Aksioni 2. Vlerësimi i situatës lidhur me punësimin.

Në këtë kontekst, do të bëhet vlerësimi i natyrës dhe nevojave lidhur me punësimin rinor sipas komuniteteve lokale si dhe vlerësimi i tregut të punës, aktivitetit, trendeve, projeksioneve dhe aftësitë që kërkohen nga të rinjtë për të aksesuar atë.

Aksioni 3. Adoptimi i politikave dhe programeve lehtësuese, motivuese dhe mbështetëse mbi aftësimin dhe punësimin e të rinjve dhe për sipërmarrjet rinore në Bashkinë Ura Vajgurore.

Aksioni 4. Bashkëpunimi me institucionet e tjera publike, biznesin dhe shoqërinë civile.

Bashkëpunimi me Zyrën e Punësimit në Berat për adresimin e nevojave të të rinjve nga Ura Vajgurore për aftësim dhe punësim. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera publike vendore. Lidhja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me bizneset që veprojnë në territorin e Bashkisë. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në fuqizimin e të rinjve.

Aksioni 5. Informim në kohë dhe efektiv.

Informim i të rinjve për mundësi punësimi/trajnimi, mbledhja e informacionit mbi punë-kërkuesit dhe orientimi i tyre drejt tregut të punës. Informimi i nxënësve për mundësitë e punësimit të përkohshëm brenda shkollave të mesme dhe institucioneve të tjera arsimore. Informim i biznesit mbi të rinjtë në kërkim të punës.

Aksioni 6. Krijimi i mundësive për ndërveprim midis aktorëve.

Portal online dhe databasë e punëkërkuesve dhe punëmarrësve. Ngritja e një Portali Punësimi për të rinjtë e Urës Vajgurore dhe pasurimi i vazhdueshëm i Portalit me lajmërimi për vende të reja pune dhe trajnime për të rinjtë. Rakordim i Portalit të Punësimit në Bashkinë e Urës Vajgurore me Portalin Kombëtar të Punësimit të të Rinjve. Organizimi i panairëve të punës. Krijimi i një network midis shkollave-institucioneve-biznesit. Rakordim i kërkesave për vende pune me ofertat e përshtatshme.

Aksioni 7: Programe konkrete për nxitjen e punësimit.

Programi mbështetës për grupet vulnerabël. Mundësimi i angazhimeve sezonale ose studentore. Projekte Pilot mbështetur në ekonominë qarkulluese. Programi për suportin dhe promovimin e talenteve.

ANEKSI IV: AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM

Bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes ky aneks synon krijimin e mundësive të barabarta për individët dhe sidomos të rinjtë që vijnë nga shtresat e varfra, komuniteti rom, aftësia e kufizuar, zonat rurale dhe gratë dhe vajzat si dhe viktimat e dhunës në familje.

OBJEKTIV: Barazia Gjinore dhe Gjithëpërfshirja në Tregun e Punës

Aksionet kryesore përfshijnë:

Aksioni 1: Krijimi i bashkëpunimit me aktorët që punojnë me barazinë gjinore

Aksioni 2: Programi i start-upeve për gratë dhe vajzat në teknologji

Aksioni 3: Programi i mbështetjes së grave dhe vajzave në zonat rurale

Aksioni 4: Programi i mbështetjes së grupeve të marginalizuara.

ANEKSI V: SIPERMARRJA

Ky aksion lidhet ngushtë me aktivitete që promovojnë sipërmarrjen, vetë-punësimin dhe bizneset sociale me qëllim zhvillimin e ekonomisë lokale në qendër dhe zonat rurale të Urës Vajgurore. Programet do të lidhen kryesisht me dhënien e granteve dhe krijimit të një grupi donatorësh që të sigurojnë qëndrueshmërinë e fondeve në fushën e sipërmarrjes.

OBJEKTIV: Promovimi i Sipërmarrjes

Objektivi është nxitja dhe mbështetja e punësimit nëpërmjet sipërmarrjes rinore. Aksionet kryesore përfshijnë:

Aksioni 1: Mbështetja e start-up rinore me ide konkrete, inovatore, të realizueshme. Organizimi i konkurseve rajonale «Ide Inovative» me qëllim nxitjen e punësimit të rinjve sipërmarrjeve rinore, të shoqëruara me mekanizma nxitës dhe mbështetës. Ngritja e inkubatorit të biznesit për sipërmarrjet rinore. Rritja e informacionit për mundësitë e financimit të start-upeve rinore. Mbështetja e aktiviteteve (artizanale, bimë medicinale, pemtari, kopshtari) që nxisin vet-punësimin e vajzave/grave të reja rurale.

Aksioni 2: Krijimi i një networkut të donatorëve

Ky rrjet do të shërbejë për krijimin e një fondi të veçantë pranë Bashkisë me synim dhënie e granteve dhe subvencioneve për projektet lidhur me sipërmarrjen rinore.

Aksioni 3: Promovimi dhe nxitja e bizneseve sociale.

OBJEKTIV: Trajnim dhe Këshillim i Specializuar për Bizneset dhe Sipërmarrësit

Aksionet kryesore përfshijnë:

Aksioni 1: Trajtime dhe Certifikime Profesionale

OBJEKTIV: Promovimi i Bizneseve Lokale

Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun kombëtar dhe rajonal është e rëndësishme zhvillimi i brendshëm i ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme duke mbështetur bizneset në zonat rurale me fokus në turizëm, bujqësi, blegtori, artizatat dhe kulinari. Aksionet kryesore:

Aksioni 1: Zhvillimi i Panairit të Biznesit Lokal

Ky panair do të zhvillohet me të gjithë bizneset që janë të interesuara të promovojnë produktet dhe shërbimet e tyre si dhe të paraqesin mundësitë e punësimit tek të rinjtë.

ANEKSI VI: PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

Në nivel lokal është e rëndësishme që institucionet të luajnë një rol rregullator dhe fasilitues midis aktorëve. Aksionet kryesore përfshijnë:

Aksioni 1: Krijimi i një Platforme Online të Punësimit

Kjo platformë (shih gjithashtu Aksioni 6, objektiva 1, Aneksi 3) do të përmbajë krijimin e një profili individual të të rinjve bazuar në Programin Individual të Orientimit. Aty mund të postohen njoftime nga punëkërkesit dhe punëmarrësit si dhe mundësi mobiliteti me rajonin dhe vendet e Europës.

Aksioni 2: Fasilitimi në Shkëmbimin e Informacionit

Ky aksion do të shërbejë në shkëmbimin e informacionit midis aktorëve që punojnë në fushën e punësimit duke i përfshirë ato në thirrje për projekte dhe iniciativa inovatore.

Aksioni 3: Të Nxisin Projektet Pilot me Donator nga Bizneset Lokale

Mbështetja e bizneseve më njëri tjetrin është një frymë e mirë e cila kultivon jo vetëm përfitimet financiare por dhe krijon një klimë më të butë dhe më oportuniste për të rinjtë. Ky aksion parashikon dhënien e donacioneve nga bizneset e mëdha kundrejtë bizneseve më të vogla apo individë me ide inovatore kryesisht atyre në zonat rurale.